



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 151/prot.
2

Tiranë, më 04.04.2017

Vendim

Nr. 9 datë 04.04.2017

Për

caktimin e masës së shpërblimit për fituesit e çmimeve shkencore kombëtare vjetore (2016), që akordohen nga Akademia e Shkencave

Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, mbështetur:

- Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, *Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë*, neni 4, pika dh;
- Udhëzimit të përbashkët mes Akademisë së Shkencave dhe Ministrisë së Financave Nr. 311/5 Prot., datë 25.10.2016 "*Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore që krijon Akademia e Shkencave*";
- Neneve 6, pika c, 7 pika c, 8 pika c, 9 pika c dhe 15 pika 1 të *Rregullores për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, për mënyrën e organizimit të konkurseve, për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre*, miratuar me Urdhrin nr. 11, datë 6.10.2016;
- Vendimit nr. 5, datë 10.10.2016, *Për shpalljen e organizimit të çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2016*;

Vendosi:

1. Të caktojë masën e shpërblimit për fituesin e çmimit *Eqrem Çabej*, rendi i parë (2016), në masën 1.000.000 (një milion) lekë.
2. Të caktojë masën e shpërblimit për fituesin e çmimit *Petrit Radovicka*, rendi i parë (2016), në masën 1.000.000 (një milion) lekë.

3. Të caktojë masën e shpërblimit për fituesin e *Çmimit të Karrierës*, rendi i parë (2016), në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.
4. Të caktojë masën e shpërblimit për fituesit e çmimit *Kërkuesi i ri më i suksesshëm*, në fushën e shkencave natyrore teknike rendi i parë (2016), në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.
5. Të caktojë masën e shpërblimit për fituesit e çmimit *Kërkuesi i ri më i suksesshëm*, në fushën e shkencave shoqërore albanologjike rendi i parë (2016), në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.
6. Fituesve të çmimeve shpërblimi i miratuar me këtë vendim u dorëzohet simbolikisht në formën e çekut gjatë ceremonisë publike të shpalljes së tyre, së bashku me diplomën dhe emblemën e çmimit.
7. Ngarkohet sektori i financës të zbatojë këtë vendim, në përputhje me legjislacionin përkatës.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Akademik Muzafer Korkuti

